



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 178/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave brenda hapësirës së ndërmarrjes publike, (stacioni i autobusëve), për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5200 (pesë mijë dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i, me datën 06.10.2013, ka pranuar një ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se me datën 06.10.2013, në rrugën “ Ahmet Kaçiku “, brenda hapësirave të ndërmarrjes publike stacioni i autobusëve, subjekti politik LDK, në Ferizaj, ka vendosur posterin me listën e kandidatëve për kuvendin e komunës, duke shkelur dispozitat ligjore mbi zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, Kodin etik të subjekteve politik, dhe kandidatëve të tyre, si dhe Rregullën Nr.01/2012, neni 3 alineja 3.2, theksohet në ankesë.

Parashtruesi i ankesës si provë i ka bashkangjitur ankesës dy fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013., PZAP-i, brenda afatit të caktuar, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se lidhur me ankesën e ushtruar kundër LDK-së, e vlerësojmë si të pabazë nga fakti se fotoja e ofruar nuk ka fare datë dhe se Dega e LDK-së, nuk ka dijeni lidhur me këtë poster, por edhe nëse me tutje ky poster i LDK-së, gjendet ende në objektin në fjalë, atëherë dega e LDK-së në Ferizaj është e gatshme ta heqë, thuhet në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Sipas pretendimeve ankimore, subjekti politik LDK, ka vendosur posterë me listën e kandidatëve për kuvendin e komunës, brenda hapësirës së ndërmarrjes publike (stacionit të autobusëve), i cili veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP, nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara të subjekteve politik, që kanë të bëjnë me vendosjen e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenja publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave, ose ndërtesave të zëna, në lidhje me fushatën zgjedhore, nga ana e subjekteve politikë.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga dëshmia, e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës identifikohet se posterit me listen e kandidatëve për kuvend të komunës nga subjekti politik LDK, janë vendosur në hapësirën e ndërmarrjes publike (stacioni i autobusëve), një veprim të tillë PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e sipërsënuara ligjore.

Në përgjigje të ankesës nuk është bashkangjitur asnjë dëshmi që kërkohet sipas nenit 32.6 të LZP-së, se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët nga shkelja e këtij Kodi.

Prandaj duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik LDK, është bërë shkelje e nenit 33 pika b) e LZP-së, neni 4.1 pika b), të Rr. Zgjedhore Nr. 11/2013, ngase janë vendosur posterë me listen e kandidatëve për kuvend komunal të subjektit politik LDK, brenda hapësirës së ndërmarrjes publike, po ashtu fakti se subjekti politik në fjalë nuk ka bërë asnjë përpjekje serioze për ti parandaluar veprimet e tilla, me qëllim të evitimit të shkeljeve të sipërsënuara, po ashtu subjekti i njëjtë politik ka bërë shkelje të kësaj natyre edhe më herët në këto zgjedhje dhe konsiderohet se i ka përsëritur shkeljet e tilla të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre të cilën PZAP, e mori si rrethanë rënduese për rritjen e dënimit, si dhe duke marrë parasysh faktorët e cituar me lartë, për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, neni 120 paragrafi 1 pika c), si dhe neni 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa në Prishtinë**

Anr. 178/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Këshillë Juridike:*** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij /do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*